

KOSOVO



KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS
KOSOVA OLYMPIC COMMITTEE

Thirrje për përgatitjen e konceptit dhe videos promovuese për Lojërat Olimpik Paris 2024

Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK) shpall konkurs publik për përgatitjen e konceptit të videos dhe realizimin e saj, e cila ka për qëllim promovimin e ekipit olimpik të Kosovës në pjesëmarrjen në Lojërat Olimpik (LO) Paris 2024, të cilat mbahen prej 26 korrik – 11 gusht në Paris të Francës.

Ekipi olimpik i Kosovës pritet të përbëhet prej 9 deri në 11 sportistë, të cilët do ta përfaqësojnë shtetin tonë ngjarjen më të madhe shumësportëshe në botë LO Paris 2024.

Sportet me të cilat ekipi ynë do të përfaqësohet janë:

- Xhudo (5 sportistë)
- Boks (1-3)
- Noti (2)
- Atletika (1).

Sporti dhe lëvizja olimpikë zënë vend të veçantë në zemrën e çdo qytetari të Kosovës. Kjo si rezultat i talentit dhe sukseseve të shumta të sportistëve tanë në arenën ndërkombëtare. Përderisa e tërë bota sheh dhe dëgjon për këto rezultate, ne jemi krenarë që edhe në Lojërat e treta Olimpikë Verore për ne, do të udhëtojmë me synimin për të fituar medalje.

Kosova në debutimin e saj në LO Rio 2016 fitoi medaljen e artë me heroinën tonë, Majlinda Kelmendin, rrugën e së cilës e ndjekën xhudistet tjera, Distria Krasniqi dhe Nora Gjakova, të cilat fituan po ashtu medaljet e arta në LO Tokyo 2020.

Kriteret e konceptit të videos:

- Të jetë origjinale, unike dhe të mos jetë imitim i ndonjë video ekzistuese, e cila promovon sportistët/sportin e Kosovës;
- Të ketë pasqyrim sportiv të LO;
- Të jetë koncept kreativ dhe profesional;
- Të jetë dinjitoz për identitetin e Kosovës;
- Të paraqet kulturën e Kosovës;
- Të promovojë sportistët;
- Të përçoj mesazh të qartë;

Mënyra e Aplikimit:

Të drejtë aplikimi kanë kompanitë e marketingut nga Kosova. Portfolio e punëve paraprake së bashku me një propozim/koncept mbi videon dhe ofertën për realizimin e videos duhet të dorëzohet përmes postës elektronike në emailin: design@noc-kosovo.org.

Vlerësimi i propozimeve do të bëhet nga një komision profesional i themeluar nga Komiteti Olimpik i Kosovës.

Data e fundit për aplikim është 15.05.2024.